

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti për Krime të Rënda, me kryetarja e trupit gjykues – gjyqtarja Ajser Skenderi, me bashkëpunëtorin profesional Arlind Sharani, në çështjen penale kundër të akuzuarit R. B., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 1 të KP, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – PP/L.nr.68/2018 të datës 07.09.2018, në shqyrtimin fillestar duke vendosur lidhur me marrëveshjes për pranimin e fajësisë PP.nr.68/2018 datë 05.09.2018, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Metush Biraj, të akuzuarit, si dhe mbrojtësit të tij av. G. Gj. nga Prizreni, me datë 13.09.2018, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

R. B., nga i ati A. dhe e ëma A., e vajzërisë C., i lindur me *data e lindjes...*, në Prizren, ku edhe tani jeton në rr. ... nr. ..., me nr. personal *numri personal...*, ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, pronar i qajtores DPH "R.", i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i dënuar për veprë të njëjtë penale në vitin 2007-2008, dhe është dënuar me dënim me gjobë në shumën prej 500 euro dhe dënim me burg në kohëzgjatje prej 33 ditë.

ËSHTË FAJTOR

Sepse pa autorizim ka poseduar me qëllim të shitjes apo shpërndarjes substanca apo preparate të cilat janë të shpallura me ligj si narkotik, substanca psikotrope apo substanca analoge, në atë mënyrë që me dt. 14.06.2018, në lokalit të tij "R." në rr. ... në Prizren, ka mbajtur 4 paketime me substanca narkotike të llojit marihuanë në peshë prej 445.93 gr, ndërsa në shtëpinë e tij në rr. ... në një kavanoz substancë narkotike të llojit marihuanë, në peshë prej 59.61 gr, në një qese plastike me ngjyrë të zezë substancë narkotike të llojit marihuanë, në peshë prej 213.66 gr, si dhe një paketim në xhepin e xhakëtës të të njëjtit, në peshë prej 0.54 gr, me substancë të llojit marihuanë, ku pesha e përgjithshme është 719.74 gr.

- Këso dore ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 1 të KP.

Andaj, gjykata në kuptim të dispozitave të nenit 7, 17, 41, 45, 46, 62 par.2.pika 2.6, në lidhje me nenin 273 par.2. të KP e

G J Y K O N

Me dënim me gjobë në shumën prej **1.200 (njëmijedyqind) euro**, si dhe dënim me burg në kohëzgjatje prej **11 (njëmbëdhjetë) muaj**, në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në masën e paraburgimit prej datës 14.06.2018 e gjer më datë 13.09.2018.

Dënimin me gjobë në shumën prej 1.200 (njëmijedyqind) euro i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë dënimin me gjobë atëherë gjykata dënimin me gjobë do t'ia zëvendësoi me dënim me burgim ashtu që një ditë burgim do ti llogaritet me 20 Euro gjobë.

Nga i akuzuari R. B. konfiskohet sasia e narkotikut e llojit „marihuanë“ në peshë prej 719.74 gram, si mjet i kryerjes së veprës penale.

Obligohet i akuzuari R. B. që konform ligjit për kompensimin e viktimave të krimit të paguajë shumën prej 50 euro, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Obligohet i akuzuari R. B. që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50 Euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, pranë kësaj gjykate, ka ngritur aktakuzën PP/I.nr.68/2018 të datës 07.09.2018, kundër të akuzuarit R. B., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 1 të KP. Poashtu Prokurori i Shtetit aktakuzës ia ka bashkangjitur edhe marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë të lidhur më datën 05.09.2018.

Gjatë shqyrtimit fillestar i akuzuari R. B. e ka pranuar fajësinë për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 1 të KP duke cekur se me Prokurorinë e Shtetit në prezencën e avokatës mbrojtëse më datën 05.09.2018 ka lidhur marrëveshje mbi pranimin e fajësisë, ka pranuar veprën penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës, paraprakisht nga ana e Prokurorit dhe avokatës mbrojtëse i është shpjeguar natyra dhe pasojat e pranimit të fajësisë, marrëveshjen për pranimin e fajësisë e ka lidhur me vullnetin e lirë pa kurrëfarë presioni, kërcënimin dhe se është pajtuar në tërësi me dënimin e rekomanduar nga ana e Prokurorit të Shtetit, andaj edhe ka propozuar që marrëveshja mbi pranimin e fajësisë të aprovohet në tërësi.

Prokurori i Shtetit poashtu ka theksuar se bazuar në kërkesën e mbrojtësit të akuzuarit për negociim të marrëveshjes për pranim të fajësisë, në prokurorinë e shtetit është ku ka qenë prezent edhe i akuzuari R. B., me mbrojtësin e tij e caktuar sipas detyrës zyrtare av. G. Gj., paraprakisht të akuzuarit i janë shpjeguar përparësit ligjore të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, dhe pasi që është bindur se i akuzuari me vulnet dëshiron që të hynë në marrëveshje për pranim të fajësisë, dhe nuk ka ndonjë ndikim kundër ligjor, se nuk ka kërcënim apo presion, është arritur marrëveshja për pranim të fajësisë, ku edhe i akuzuari është pajtuar me lartësinë e dënimit të rekomanduar.

Mbrojtësja e të akuzuarit avokat G. Gj. ka theksuar se marrëveshja e lidhur mbi pranim të fajësisë në zyrën e prokurorit të shtetit është e lidhur me vullnet të lirë, pa presion, dhe se të mbrojturin e tij paraprakisht e ka njoftuar për dënimin e rekomanduar dhe natyrën e kësaj marrëveshje të arritur.

Në shqyrtimin fillestar pasi që i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale blerja, posedimi shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotike, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 1 të KP, gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë dhe marrëveshjen e arritur mbi pranimin e fajësisë, i cili pranim është bërë konformë nenit 248 në lidhje me nenin 233 par. 18 të KPP, i akuzuar ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht pas konsultimeve me mbrojtësin e tij, pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova materijale të rastit konkret dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 par. 1 dhe 2 të KPP, gjykata ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit formohen elementet qenësore të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 1 të KP, pasi që pa autorizim ka poseduar me qëllim të shitjes apo shpërndarjes substanca apo preparate të cilat janë të shpallura me ligj si narkotik, substanca psikotrope apo substanca analoge, në atë mënyrë që me dt. 14.06.2018, në lokalin e tij "R." në rr. ... në Prizren, ka mbajtur 4 paketime me substanca narkotike të llojit marihuanë në peshë prej 445.93 gr, ndërsa në shtëpinë e tij në rr. ... në një kavanoz substancë narkotike të llojit marihuanë, në peshë prej 59.61 gr, në një qese plastike me ngjyrë të zezë substancë narkotike të llojit marihuanë, në peshë prej 213.66 gr, si dhe një paketim në xhepin e xhakëtës të të njëjtit, në peshë prej 0.54 gr, me substancë të llojit marihuanë, ku pesha e përgjithshme është 719.74 gr.

Duke u bazuar në mendimin juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës GJA nr.207/13 të datës 19.03.2013, kryetarja e trupit gjykues ka vazhduar me shqiptimin e dënimit pa e plotësuar fare trupin gjykues dhe pa shkuar fare në shqyrtim, duke ia shqiptuar dënimin e cekur si në dispozitiv.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin konformë nenit 41 të KP, përkitazi me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në të njëjtën duke marrë parasysh qëllimin e dënimit, të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në zbutjen apo rritjen e dënimit, shkallën e përgjegjësisë, motivet nga të cilat është kryer vepra penale, prej rrethanave lehtësuese morri parasysh faktin se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, dhe ka arritur marrëveshje mbi pranimin e fajësisë, qëndrimin korrekte të tij në gjykim, se është i moshës së re. Ndërsa prej rrethanave rënduese motivin e kryerjes se

veprës penale-motivi është përfitimi material si dhe pesha e veprës së kryer penale, andaj është mendimi i gjykatës që dënimi i shqiptuar do ta arrijë qëllimin e vet konformë nenit 41 të KP, se dënimi i shqiptuar është në harmoni me intenzitetin e dëmtimit të vlerës së mbrojtur, si dhe me shkallën e përgjegjesisë penale të akuzuarit dhe se do të mundësoj një balans të drejtë në mes të kërkesave që të akuzuarit ti mundësohet risocializimi dhe kërkesës së shoqërisë që ai dënim me peshën e tij të ketë karakter të përgjithshëm parandalues nga kryerja e veprave penale, të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit të respektimit të ligjit. Gjykata është e mendimit se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është në shërbim të preventivës së përgjithshme, posaçërisht të asaj të posaçme, se do të ndikoj në forcimin e moralit të shoqërisë, përgjegjesisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe është në pajtueshmëri me kërkesat për siguri personale të popullatës së kësaj treve dhe se me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit në të gjitha segmentet e sajë.

Vendimi mbi dënimin plotësues është marrë konformë nenit 62 par.2 nën.2.6 të KP.

Vendimi mbi llogaritjen e paraburgimit në dënimin e shqiptuar është marrë konformë nenit 83 par.1 të KP.

Vendimi mbi taksën gjyqësore në emër të kompensimit të viktimave të krimit, është marrë në pajtim me nenin 39 par. 3 nën par. 3.2 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit Nr.05/L-036.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konformë nenit 450 par.2 pika 2. 6 në lidhje me nenin 453 par.1. të KPP.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr.73/2018 me datë 13.09.2018

B. Profesional
Arlind Sharani

Kryetarja e trupit gjykues
Ajser Skenderi

UDHËZIM JURIDIKE: Pasiqë palët me të drejtë ankese kanë hjekur dorë nga e drejta ankesës, andaj, ky aktgjykim me ditën e shpalljes më datën 13.09.2018 bëhet i plotfuqishëm.